



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –Tiranë

Nr. 5302/prot
7

Tiranë më, 24/12/2018

VENDIM

NR. 39 DATË. 04/12/2018

PËR

MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR “MIRATIMIT NË PARIM PËR PËRDORIM TË
BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE, NGA HEC VRRI
SUBJEKTIT “INTER ALB DISTRIBUTION ” SH.P.K.

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” të ndryshuar, përkatësisht të nenit 42 pika 3; Neni 50, pika 2, neni 52 gërma c ; të VKM-së Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme , dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedura ve të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, neni 24, gërma “f” ndryshuar me VKM nr. 718 datë 12.10.2016, me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit “**INTER ALB DISTRIBUTION**” shpk Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen ,

KONSTATOI SE,

Bazuar në shkresën Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, ndërtimi i “Hec Vri” sipas ligjit 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” është në zonë të mbrojtur në kategorinë “Peisazh i mbrojtur mali me Gropa Bizë, Martanesh ” (nënzona e përdorimit tradicional). Administrata e Zonave të mbrojtura është shprehur kundër miratimit të “HEC-eve” në zonë të mbrojtur.

Për këto arsye, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm - Erzen,

V E N D O S I:

1-Mosmiratimin e kërkesës “për miratimin në parim për përdorim të burimit ujor për energji elektrike nga Hec Vri subjektit “**INTER ALB DISTRIBUTION**” shpk” administrator **Z.Besim MULAJ**, për përdorim të burimit ujor në rrjedhën e përroit të Kasolle, degë e lumit të

Erzen, për prodhim energjie elektrike, pranë fshatit Vvri, bashkia Tiranë, Qarku Tiranë me këto të dhëna :

- Koordinatat e veprës së marrjes Nr.1 X – 44 25 276 Y –45 78 270 Z- 926
- Koordinatat e veprës së marrjes Nr.2 X – 44 25 203 Y –45 78 463 Z- 927
- Koordinatat e veprës së marrjes Nr.3 X – 44 24 640 Y –45 78 998 Z- 949
- Godina e centralit me koordinata : X- 44 23 001 Y- 45 77 386 Z- 580
- Prurja mesatare e veprës së marrjes Nr.1 Q mes= 0.133 m³/sek;
- Prurja mesatare e veprës së marrjes Nr.2 Q mes= 0.058 m³/sek;
- Prurja mesatare e veprës së marrjes Nr.3 Q mes= 0.058 m³/sek;
- Prurja ekologjike e veprës së marrjes Nr.1 Q₃₅₅= 0.0064 m³/sek;
- Prurja ekologjike e veprës së marrjes Nr.2 Q₃₅₅= 0.0028 m³/sek;
- Prurja ekologjike e veprës së marrjes Nr.3 Q₃₅₅= 0.0028 m³/sek;
- Prurja që shkarkohet e veprës së marrjes Nr.1 Q_{llog}= 0.2 m³/sek.
- Prurja që shkarkohet e veprës së marrjes Nr.2 Q_{llog}= 0.08 m³/sek.
- Prurja që shkarkohet e veprës së marrjes Nr.3 Q_{llog}= 0.08 m³/sek.
- Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë VM 1 Q_{vaditëse}=0.06 m³/sek
- Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë VM 2 Q_{vaditëse}=0.02 m³/sek
- Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë VM 3 Q_{vaditëse}=0.02 m³/sek
- Fuqia e instaluar E= 828 KW

2-Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

- Shfrytëzimi i burimeve ujore në zonë të mbrojtur, në katëgorinë “Peisazh i Mbrojtur, Mali me Gropa,Bizë Martanesh.


3.Ngarkohet ABU Ishëm-Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM -ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUNI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

